

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Ekstrakti nga procesverbali, mbledhja e pestë - V të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 30.05.2024, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës, e ndërprerë dhe vazhduar me datën 18.06.2024.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete.

Mirlinda Krasniqi, Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Doruntina Jashari, Shpend Bardiqi, Habib Mekolli, Vlonjat Hasani, Mirsad Qyqalla, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Mungon: Fidan Berisha.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Besnik Osmani - Nënkryetar i Komunës, Amir Bullatovci - Drejtor për Administratë, Fatlum Berisha - Drejtor për Arsim, Bardhyl Kojçiçi - Drejtor për Infrastrukturë, Mimoza Kolshi - Drejtoresë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ali Topalli - Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport, Ardit Sekiraqa - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Ilir Hasani - Drejtor për Gjeodezi Kadastër e Pronë, Vjosa Kida Hyseni - Drejtoresë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Arbër Statovci - Drejtor për Inspektorat.

Të tjera: Lindita Dervisholli / Prebreza - Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, Faton Ajeti - OSBE.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Informatë për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - Rekos 2024 në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Propozim për ndërrimin e destinimit të objektit të vjetër të shkollës në fshatin Pomozotin, në objekt për Arkivën Komunale.
3. Propozim për shqyrtimin e kërkesës për shpalljen e titullit 'Qytetari nderi' për vitin 2024 në Komunën e Fushë-Kosovës.
4. Propozim për formimin e Komisioneve, për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës.
5. Rishqyrtimi i vendimit Nr. 08, të datës 07.02.2024 për shndërrimin e tokës bujqësore, në tokë ndërtimore për palën Gëzim Bullatovci.
6. Informatë për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2025.
7. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndeti të pranishmit në mbledhje. Lexoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme, paraqiti para Kuvendit të Komunës, edhe dy rekomandime nga mbledhja e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete dhe hapi diskutimin.

Laureat Gojnovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kërkoj që në këtë mbledhje të shqyrtohet propozimi për zëvendësimin e anëtares së Komitetit për Komunitete znj. Linda Hyseni me anëtarë tjerë, meqë kjo nuk vjen në mbledhje, mos kryerja e obligimeve që rrjedhin nga ligji, kërkon veprimin e Kuvendit të Komunës.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kjo punë është e rregulluar me ligj, por duhet të konstatohet kjo punë, në aspektin formal, të ftohet anëtarja e kaluar, të deklaron pse nuk merrë pjesë në mbledhjet e Komitetit për Komunitete.

Mirsad Qyqalla: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me materialin për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, na ka ardhur vonë, andaj lidhur me këtë punë unë e shprehi pakënaqësinë time, sepse këto punë duhet të përcjellen me kohë, pasi që ju i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, kërkonte nga ana e Ekzekutivit të Komunës, që pikat për shqyrtim në rendin e ditës, të dorëzohen deri me datën pesëmbëdhjetë të muajit përkatës, pra shumë kohë përpara, mbështetur në orientimin e 'Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024'.

Hasan Ismajli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë kërkoj që në rendin e ditës të jetë në shqyrtim sot edhe dy marrëveshjet me prijësit fetar të lidhura nga Kryetari i Komunës, jashtë rregullave ligjore, duke e anashkaluar edhe zbatimin e 'Rregullores për shërbimet e varrimit dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', të miratuar në Kuvendin e Komunës në janar të vitit 2023.

Qëndresa Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë tani dua të flas këtu për qasjen e kolegut tonë z. Bashkim Krasniqi, i cili për anëtarë të Komitetit për Komunitete, e propozon vetën, pa ndonjë konsultim me neve, nuk është korrekt me mbrojtjen e interesave të qytetarëve, e ftoi të reflekton, sepse unë sipas marrëveshjes tonë e kam votuar atë për pozitën e Zëvendës Kryesues të Kuvendit të Komunës për Komunitete, ai e gëzon këtë pozitë, unë e kam votuar edhe z. Suhat Ademi për pozitën e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete, ai është deklaruar edhe si ashkali, ndërsa ka qenë përfaqësues i komunitetit egjiptian, këto janë lojëra e tyre të tmerrshme, për të marrë pozita zyrtare, duke e shfrytëzuar pozitën z. Bashkim Krasniqi, merrë mjete financiare në shëndetësi, në biznes, e ka punësuar vajzën e tij në Qendrën për Punë Sociale, këto favore janë të tmerrshme, andaj lidhur me propozimin e tij, unë do të dal kundër.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne tani secilin propozim do ta hedhim në votim, nëse kalojnë si propozime do të shqyrtohen, duke respektuar qëndrimin e secilit anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Hasan Ismajli: Lidhur me propozimin për anëtarë të Komitetit për Komunitete, duhet të lexohen dispozitat e Statutit të Komunës dhe Udhëzimit Administrativ, për caktimin e anëtarëve tjerë të Komitetit për Komunitete që vijnë jashtë Kuvendit të Komunës, duhet të respektohen procedurat, ashtu sikur janë të shkruara, të mos bëhen shkelje të akteve juridike.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani pas qartësimeve lidhur me procedurat, e qes në votim ‘Propozimin për zëvendësimin e anëtares së Komitetit për Komunitete, me përfaqësuesin tjetër egjiptian’.

U votua me: trembëdhjetë vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej trembëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se ‘Propozimi për zëvendësimin e anëtares së Komitetit për Komunitete, me përfaqësuesin tjetër egjiptian’, në mungesë të votave të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, nuk kalon për shqyrtim.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme rendin e ditës.

U votua me: nëntëmbëdhjetë vota ‘për’, një votë ‘kundër’ dhe katër abstenime, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, e aprovuan për shqyrtim rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

Pika e parë (1) - Informatë për regjistrimin e popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare - Rekos 2024 në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për analizë ‘Informatën për regjistrimin e popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare - Rekos 2024, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’, të organizuar nga institucioni përgjegjës Agjencia e Statistikave të Kosovës, meqë kjo Informatë për regjistrimin e popullsisë, është përgatitur nga Drejtorja e Administratës, për Kuvendin e Komunës, sepse kjo drejtori ka qenë i kyqur në këtë proces që nga fillim, andaj e ftoi ta merrë fjalën për të na dhënë sqarime shtesë.

Drejtori për Administratë: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam përgatitur këtë: Informatë për regjistrimin e popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare - Rekos 2024, për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, kam qenë anëtarë i Komisionit Komunal për Regjistrim, i caktuar me vendimin e Kryetarit të Komunës, që i ka paraprijë këtij procesi të rëndësishëm për komunën tonë dhe vendin tonë, unë tani në vija të trasha e kam paraqitur një pasqyrë të rrjedhës së këtij procesi, që ka zgjatur për dy muaj, në kordinim dhe bashkëpunim të plotë me organizatorin e regjistrimit të popullsisë Agjensinë e Statistikave të Kosovës, procesi i regjistrimi i popullsisë ka filluar me datën 5 prill 2024 dhe ka vazhduar deri me datën 24 maj 2024. Për regjistrimin e popullsisë, është bërë një ounë e madhe, edhe nëpërmjet emisioneve televizive dhe informimit që është bërë nga anëtarët e Ekzekutivit të Komunës, Kuvendit të Komunës, përfaqësuesit e komuniteteve, prijësit fetar e tjerë. Paraprakisht janë mbajtur tri takime, me Kryetarin e Komunës, me përfaqësuesit e Agjensisë së Statistikave të Kosovës për mbarëvajtjen e këtij procesi. Ekzekutivi i vendit, është angazhuar në nivel vendi, duke përfshirë të gjithë akterët këtu pastaj nga ne për rëndësinë e regjistrimit të popullsisë, duke dhënë shpjegime e sqarime, e gjithë kjo punë është bërë për të siguruar një mirëqenie më të mirë për banorët e komunës tonë. Në pjesën e dytë të regjistrimit, ku ne e kemi kërkuar vazhdimin e tij, edhe për një javë, regjistruarit kanë punuar me sistemin e GPS-së, ku disa banorë nuk kanë mundur të regjistrohen në zonën periferike të komunës tonë, sepse në sistem kanë figuruar në territorin e Komunës së Graçanicës, kjo punë është rregulluar kohën e fundit, me përfshirjen e të gjithë akterëve relevantë. Sipas disa statistikave të publikuara para disa kohe edhe nga vetë organizatori Agjensioni i Statistikave të Kosovës, ne do

të bëjmë pjesë në komunat e mëdha, mbështetur në të dhënat e statistikave të regjistrimit, kur do që ato jipen si rezultate preliminare, që edhe në rezultatin përfundimtarë nuk mund të ketë ndryshime të mëdha. Publikimi i statistikave është në diskrecion të Agjensisë së Statistikave të Kosovës, sipas publikimeve të tyre, me datën 09.05.2024, ne kemi qenë 54 mijë banorë, ndërsa me datën 13.05.2024, kur në nivel vendi si banorë rezidentë kanë qenë 1.4 milion, ne kemi qenë 58 mijë banorë ose 4.06%, si Komunë e Fushë-Kosovës, rezultatet preliminare pritet të jepen në fund të qershorit ose në fillim të korrikut, ne pritet të jemi komuna e gjashtë ose e shtatë në nivel vendi, por për këtë process të rëndësishëm për ne si komunë, duhet të presim rezultatet zyrtare nga Agjensia e Statistikave të Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë për të gjitha këto informata shtesë e falënderoi Drejtorin e Drejtorisë së Administratës, mirëpo ky proces e kërkon një legjitimitet të saktë dhe konfirmim nga Agjensia e Statistikave të Kosovës, mirëpo informata e dhënë është shumë e dobishme për ne, sepse ju keni qenë anëtarë i Komisionit Komunal për Regjistrim dhe i kyqur në këtë punë që nga fillimi.

Habib Mekolli: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Në procesin e regjistrimit të popullsisë Kryetar i Komisionit Komunal për Regjistrim, është Kryetari i Komunës, realisht pritshmëritë për këtë rezultat kanë qenë, edhe para fillimit të këtij procesi me rëndësi për qytetarët e komunës tonë, kjo na jep neve pak shpresë për të ardhmen, se do të kemi më shumë buxhet për arsim, shëndetësi dhe shërbime tjera publike, që ka nevojë shumë sidomos në zonën urbane të komunës, sepse ne jemi dëshmitar se kemi shumë ngecje në përcjelljen e ndërtimeve të larta, me infrastrukturë sociale dhe ofrim të shërbimeve publike për banorët e zonën urbane. Ne shpresojmë dhe besojmë që buxheti, që pritet të ndahet në të ardhmen në bazë të rezultatit të regjistrimit të popullsisë, do të shkon drejtë në destinimin e tij kryesorë për investime publike në infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi, në ndërtimin e objekteve shkollore, pastaj objekteve tjera për kulturë dhe rini. Mendimi ynë i përgjithshëm është se regjistrimi i popullsisë, do të ndikon në kualitetin dhe mirëqenien e jetesës së qytetarëve.

Hasan Ismajli: Regjistrimi i popullsisë, është një e mirë që i ka ndodhur komunës tonë në kohën e duhur, sepse pritet të kemi lehtësime dhe mundësi për punësime të reja në arsim dhe shëndetësi, ku nevojat janë shumë të mëdha, ku me vite kemi qenë para kollapsit të përgjithshëm. Ne e kemi patur një respekt për punën e regjistruesve të terrenit, që kanë ardhur në shumë raste edhe nga dy herë të banesat tona në qytet, por i kemi edhe disa vërejtje për punën e Komisionit Komunal të regjistrimit, duke filluar nga Kryetari i Komunës dhe anëtarët e tjerë të Komisionit, të cilët e filluan më vonë e filluan me reklamim dhe informim për rëndësinë e regjistrimit nga anëtarët e Ekzekutivit të Komunës, pastaj më vonë edhe me anëtarë të Kuvendit të Komunës, port ani unë dua ta paraqes një rast të një familjari tim, ky regjistruesi ka qenë nga Vranjevci, ka ardhur tre ditë dhe nuk ka mundur ta kryen regjistrimin e asaj familje, po ashtu kemi dëgjuar edhe vërejtje tjera nga qytetarë të tjerë, që kanë patur vështirësi. Për mundësinë e regjistrimit të banorëve të Luginës që jetojnë në Komunën e Fushë-Kosovës dhe vijnë nga Komuna e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, me kodin zero, unë vetë këtë punë e kam kuptuar nga Nënkryetari i Komunës, që ka qenë në një emision televiziv me përfaqësues të Agjensisë së Statistikave të Kosovës, për reklamimin dhe informimi për këtë punë nuk është bërë, në informimin e bërë nga komuna jonë, këtu është lëshuar një mundësi e mirë për regjistrimin e këtyre banorëve, që janë në numër bukur të madh në komunën tonë, andaj kjo punë e paraqet një lëshim të madh, sepse ne kemi patur

përfaqësues me dinjitet për informim të këtyre qytetarëve, sikur e keni patur ju Ish/Drejtoreshën e Administratës me origjinë nga Lugina e Preshevës.

Shpend Bardiqi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Dallimi këtu është se ju jeni të kënaqur me numrin e banorëve, ka arritur në gjashtëdhjetë mijë, por ju duhet ta shihni banimin dhe kushtet që ofrohen nga komuna vetëm në lagjen e Dardanisë, ku ka shumë ndërtime, banorët kanë ardhur, por dora e shtetit e komunës mungon, këtu banorët kanë ardhur edhe nga fshatrat tona, investimet nuk janë të ndara si duhet, duhet të ishin 50 me 50 në qytet dhe fshatra, por ju e shihni dallimin në buxhet me vite të tëra. Këtu Drejtori i Drejtorisë së Administratës dhe Kryetari i Komunës, e kanë bërë një lëshim të madh me pasoja, duke mos e bërë informimin për regjistrimin e popullsisë me origjinë nga Lugina e Preshevës me kodin zero, që e ceku kolegu ynë z. Hasan Ismajli, kjo punë është shumë keqë, sikur edhe shumë punë tjera që bëhen nga ju. Investimet publike dhe taksat e mëdha që mbledhen në qytet, nuk duhet të shkojnë në një mahall të fshatit Bardh i Madh apo Graboc i Poshtëm, por ato duhet të jenë të baraz peshuara në qytet dhe në fshatra, aty ku ka nevojë, rast tipik i keqë planifikimit dhe keqë menaxhimit është mbjellja e pemëve dekorative, ku shumica e tyre nuk janë në teren, sepse investimet janë duke u bërë, pa një planifikim të mirëfilltë dhe si duhet nga institucionet komunale.

Mirsad Qyqalla: Ne të gjithë subjektet politike, i kemi kushtuar një vëmendje të shtuar regjistrimit të popullsisë, për të arritur një rezultat sa më të mirë në teren, në mënyrë që të gjithë të interesuarit për regjistrim, të regjistrohen si banorë rezidentë të komunës tonë, sepse procesi i regjistrimit të popullsisë ndodh vetëm njëherë në dhjetë vjet dhe në bazë të statistikave zyrtare ndahet buxheti për komuna, kjo çështje ka qenë një ngarkesë e madhe, për një jetë normale, sepse rritja e qytetit tonë është bërë pa një plan të mirëfilltë, andaj ne i kemi përkrahur aktivitetet komunale, për të rritur sa më shumë numrin e banorëve që regjistrohen. Këtu po shihet se prapë, nuk është bërë mjaftueshëm për të bërë regjistrimin e qytetarëve me origjinë nga Lugina e Preshevës. Komuna e Fushë-Kosovës i ka specifikat e veta, ka pasur një zhvillim të veçantë, andaj është rritur popullsia, është dyfishuar, pa një informim, sepse shkuarja e regjistruarëve nëpër banesa, do të shndërrohet në një çështje relative, ndoshta me një angazhim shtesë, do të mund të arrihet edhe më shumë, sepse ne për dhjetë vite kemi qenë në një nivel të ulët të përfitimit nga buxheti qendrorë, me ndërtimet në qytetin tona ka qytetarë që kanë mbetur të pa regjistruar, nuk dihet saktësisht numri i tyre. Numri i banorëve më shumë, do të thotë rritje e buxhetit të komunës, shërbime më cilësore në arsim, shëndetësi dhe infrastrukturë, shërbime më të mira publike, neve që jetojmë në qytet e shohim më së mirë, ngarkesën e jetës së përditshme, tani pyetja legjitime është kur do të zyrtarizohet ky regjistrim, sipas disa informative është në nëntor, andaj përfitimet eventuale nga buxheti me rritje pritet të realizohen në komunën tonë, vetëm pas një viti.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne në këtë proces të rëndësishëm për ne kemi bërë pak politikë, duke punuar me aktivitete të ndryshme për ndikuar në regjistrimin e secilit qytetarë që ka shprehur dëshirë të regjistrohet, kemi shtuar aktivitetet e informimit nga drejtorët komunale, Këshillin e Prindërve, anëtarët e Kuvendit të Komunës, Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, përfaqësuesit e komuniteteve, përfaqësuesit e komunitetit fetarë, sepse kemi menduar se kanë ndikim pozitivë në këtë proces jetikë për rritjen e banorëve rezidentë në komunën tonë, ua kemi shpjeguar atyre se kjo punë nuk ka ndikim në listën e votuesve, por ka ndikim të madh në ofrimin e shërbimeve të mira administrative dhe publike, shërbimeve në arsim dhe shëndetësi për të gjithë qytetarët që jetojnë në Komunën e Fushë-

Kosovës. Gjatë procesit ka patur të meta, në fillim disa regjistruar e kanë lënë punën e tyre, ne e kemi hapur edhe një zyrë këtu në objektin e komunës, ku janë ofruar informata për të gjithë secilën ditë. Në informim dhe senzibilizim kontributin e tyre e kanë dhënë edhe anëtarët e Kuvendit të Komunës z. Laureat Gojnovci, z Mirsad Qyqalla, unë po ashtu dua të ju njoftoj se janë edhe tre mijë deri në pesë mijë banorë që janë regjistruar në zonën e pjesës së Uglarit, që shërbimet publike i marrin në komunën tonë, për arsye të afërsisë, të cilët në fillim nuk janë regjistruar nga Komuna e Graçanicës, ku është një fakt se me libra kadastral këta banorë janë të Fushë-Kosovë, për këtë çështje nuk ka një qartësim, as nga Qeveria e Kosovës, kjo zonë me Pakon e Ahtisarit dhe Ligjin për Kufijtë Kadastral, kjo zonë ka kaluar në zonën e Komunës së Graçanicës, me një mirëkuptim këta banorë këta banorë duhet të verifikohen dhe të vendosen si banorë të Komunës së Fushë-Kosovës. Në vitin 2000 komuna jonë ka patur vetëm shtatëmbëdhjetë mijë banorë, në vitin 2011 ky numër është rritur në tri dhjetë e katër mijë banorë, ndërsa me regjistrimin e vitit 2024, pritet të kemi rreth shtatë dhjetë mijë banorë. Këtu rezultatin preliminar kompetentë është ta jap zyrtarisht Agjensia e Statistikave të Kosovës, por fakti dhe e vërteta është se në Komunën e Fushë-Kosovës pritet të kemi mbi gjashtë dhjetë e tre mijë banorë, ne kemi krijuar kushte të mira të jetesës dhe mirëqenies ekonomike, duke e rritur numrin e popullsisë nga shtatëmbëdhjetë mijë banorë në shtatë dhjetë mijë banorë, numri i popullsisë është rritur më së shumti në komunën tonë, ka një rritje më të vogël edhe në Komunën e Prishtinës dhe Komunën e Ferizajit, kjo rritje ka ndodhur kur popullsia në nivel vendi është zvogëluar nga dy milion banorë në 1.5 milion banorë. Sipas informative që kemi rezultatet përfundimtare priten të jepen në muajin nëntor të këtij viti, nga ky regjistrim ne do të fitojmë rreth shtatë milion buxhet më shumë, ne e kemi bërë një kalkulim me pesë dhjetë e pesë mijë banorë, ku ne do të marrim 6.2 milion euro më shumë nga buxheti i shtetit, por ky buxhet pritet të jetë në disponim për komunën tonë, vetëm në buxhetin e vitit 2026, por synimi ynë në periudhën e ardhshme është që të arrijmë numrin e banorëve të një qyteti me një qind mijë banorë.

Hasan Ismajli: Tani ne ju falënderojmë juve i nderuari Nënkyetar i Komunës, por edhe të tjerët që kanë punuar në informimin e qytetarëve për rëndësinë e procesit të regjistrimit të popullsisë. Ju e cekët edhe faktin e banorëve të zonës së Uglarit, por unë dua të shtoi këtu pjesën e banorëve të objektet banesore të Kompanisë 'Al Trade', që me planin e Ahtisarit janë të komunës tonë, sepse këtu te ne i marrin shërbimet publike, arsimore, shëndetësore dhe administrative, këta janë dikun rreth tre mijë banorë, që Komuna e Graçanicës nuk kanë dashur të regjistrojnë për arsye politike, të ruajtjes së pushtetit në komunën e tyre, sipas Hartës Zonale të Komunës, kur merr shërbime të Restoranti 'Mero', në faturë shkruan se jeni në territorin e Komunës së Graçanicës. Vërejtje ime kryesore që e kam thënë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa është, se nuk është punuar në senzibilizimin e opinionit për regjistrimin e banorëve me origjinë nga Lugina e Preshevës, me kodin zero, kjo punë nuk është bërë nga komuna jonë, llogaritet se këta banorë mund të jenë nga tetë mijë deri në dymbëdhjetë mijë, këta banorë janë të diskriminuar edhe në Republikën e Kosovës, edhe në shtetin serb, por ju i keni diskriminuar me pa mundësinë e pjesëmarrjes së tyre në këtë regjistrim. Unë kam kërkuar sqarim, edhe në lidhje me pranimin teknik të objektit banesor të 'Eliza C' në Fushë-Kosovë, kur është ndërtuar ky objekt nuk ka pasur Hartën Zonale të Komunës, fjala është për një mbi ndërtim prej 1000 metra katror, ku është ndarë për nevojat e komunës si interes publik një sipërfaqe e lokalit prej 400 metra katror, pyetja ime këtu

ka qenë, a është në disponim kjo sipërfaqe për nevoja të interesit publik komunal ende si pronë në këtë objekt banesor.

Nënkryetari i Komunës: Në Komunën e Fushë-Kosovës nuk është diskriminuar askush, për të patur ndikim në regjistrimin e popullsisë, ne e kemi bërë informimin edhe nëpër shkolla, mos përfshirja e tyre në regjistrim është një gjë jo e mirë, por informimi ka qenë obligim edhe i nivelit qendrorë, ndërsa për regjistrimin e banorëve të zonës së Uglarit, që shërbimet i marrin në komunën tonë dhe kanë shprehur dëshirën që të regjistrohen si banorë të komunës tonë, për këtë çështje jemi duke punuar me Agjensinë e Statistikave të Kosovës, si organ kompetentë për regjistrimin e popullsisë, andaj nuk duam që të kemi ndikim politikë dhe të keqëpërdoret foltorja e Kuvendit të Komunës, lidhur me procesin e regjistrimit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Në rregull është kjo që u cekë nga Nënkryetari i Komunës, që keni tentuar të shtyeni diçka në këtë process me ndikim në politikat publike, por mendimi im është që këtë punë dhe rezultatin e regjistrimit të ia lëjmë kohës dhe organit kompetentë Agjensisë së Statistikave të Kosovës, që ta bëjnë punën e tyre dhe ta mbyllin mirë këtë process të regjistrimit.

Nënkryetari i Komunës: Në Komunën e Fushë-Kosovës të gjithë qytetarët janë të barabartë, në qytetin tonë kanë ardhur banorë edhe nga fshatrat tona si: Bardh i Madh, Sllatina e Madhe, Lugina e Preshevës, Pudujeva, Gjakova dhe vendet tjera.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne e falënderojmë Drejtorin e Drejtorisë së Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës, për këtë informatë lidhur me regjistrimin e popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare, sepse na ofron të dhëna të mira për rrjedhën e këtij procesi me rëndësi publike për komunën tonë.

Pika e dytë (2) - Propozim për ndërrimin e destinimit të objektit të vjetër të shkollës në fshatin Pomozotin, në objekt për Arkivën Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi për shqyrtim 'Propozimin për vendosjen e Arkivit të Komunës së Fushë-Kosovës, në objektin e shkollës së vjetër të fshatit Pomozotin', për më shumë sqarime lidhur me këtë çështje e ftoi propozuesin Drejtorin e Drejtorisë së Administratës.

Drejtori për Administratë: Unë do të jem i shkurtër në diskutimin tim, ne propozojmë që të bëhet ridestinimi i objekti të vjetër shkollorë në fshatin Pomozotin, në objekt të destinuar për Arkivën Komunale, pasi që gjendja e këtij objekti është jo e mirë, ne në një takim me Kryeshefin Ekzekutiv të Arkivit të Kosovës, kemi diskutuar për bashkëpunimin tonë dhe hartimin e një listës së veprimeve që duhet të ndër mirren, ata na kanë ofruar përkrahjen e tyre profesionale, për klasifikimin e dokumentacionit të komunës tonë, ata na kanë rekomanduar se duhet të hartojmë edhe një 'Rregullore Komunale për strukturimin e materialit arkivor në nivel të njësisive', meqë ruajtja aktuale e dokumentacionit zyrtar është në gjendje jo të mirë, ne i kemi rreth 1800 metra gjatësi material arkivor, andaj ne kemi propozuar që në fazën fillestare ta bëjmë ndërrimin e destinimit të objektit të vjetër shkollorë në fshatin Pomozotin, i cili duhet të renovohet dhe përshtatet për objekt të Arkivës Komunale. Në aspektin profesional duhet ta caktojmë listën e ruajtjes së dokumentacionit, klasifikimin e dokumentacionit si institucion fond krijues, ku 60% e dokumentave arkivore duhet të asgjësohen, ndërsa vetëm dokumentacioni me vlerë të përhershme të ruajtjes pas klasifikimit të tij, duhet të sistemohet sipas rregullave dhe kritereve për arkivat. Këtij objekti pas renovimit duhet t'i bëhet edhe një sigurim fizik, duhet të bëhet sigurimi për mbrojtje

nga zjarri, letrat e caktuara duhet ta kenë lartësinë standarde për ruajtje. Infrastruktura ligjore për klasifikimin dhe asgjësimin e dokumentave të pa vlera, sipas ligjit për arkiva, që nuk duhet të ruhen, rekomadohet të asgjësohet nga një Komision përkatës, duhet të punojmë edhe për krijimin e arkivës së dixhitalizuar.

Nënkryetari i Komunës: këtu nuk kemi të bëjmë me Arkivën Komunale, për me Arkivën Komunale të Qytetit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Në fillim para rrënimin duhet të shikohet, ku objekt meqë është i vjetër më shumë se pesëdhjetë vite, unë jam në madnatin e tretë dhe që nga fillim kam kërkuar zgjidhje për këtë shkollë, pas ndërtimit të objektit të ri shkollorë në këtë fshat, në fillim të këtij procesi në start, porpozimi është i mangët, këtu kemi të bëjmë me ngastrën kadastrale me numër 00256-0, me një sipërfaqe prej: S-8350m², por edhe pjesa për sistemimin e dokumentacionit atje është shumë abstrakte, unë në mirëbesim dje kam kërkuar, që të shikohet, edhe baza ligjore, te ligji për arkivat, tani neve këtu po na thuhet se nuk kemi të bëjmë me dokumentacionin e Administratës tonë, por kemi të bëjmë me krijimin e Arkivës së Qytetit. Unë jam idhtar që të bëhet diçka të lëvizet, sepse në atë objekt janë zhvilluar dukuri jo të hijshme dhe negative, por nëse ridestinohet në objekt për arkiv, aty duhet të bëhet edhe një sigurim i mirë i objektit, të mendohet mirë, sepse ne tani jemi një komunë e madhe me mbi gjashtë dhjetë mijë bamorë. Kjo punë duhet të mirret si diçka serioze, ne këtu nuk e dijmë as koston e për afërtë të renovimit të këtij objekti me rëndësi publike, nuk na sqarohet shumë as për dixhatilizimin e arkivës dhe materialit arkivorë, ne në materialin e marrë nuk e kemi një paramasë për shpenzimet e renovimit të këtij objekti.

Laureat Gojnovci: Unë e falënderoi Drejtorin e Drejtorisë së Administratës, për përgatitjen e këtij propozimi për fillimin e procedurave për sistemimin dhe ndarjen e materialit arkivor, tani në këtë fazë kërkohet të bëhet vetëm ridestinimi i objektit të shkollës së vjetër, në objekt publik për Arkivën e Komunës, pjesa tjetër e ngastrës kadastrale i takon shkollës, ku ndërrim është i mirë, sepse aty deri tani janë zhvilluar dukuri negative, dhunë përdorim i substancave narkotike e tjera, andaj ne në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë nga Lidhja Demokratike e Kosovës, e përkrahim për aprovim propozimin e Ekzekutivit të Komunës për ridestimin e këtij objekti shkollorë, në objekt për Arkivën Komunale, i cili në faza tjera do të renovohet dhe përshtatet për objekt të Arkivës Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ky vendim nuk është i përgatitur mirë, sepse mungon kompletimi i dokumentacionit.

Vlonjat Hasani: Unë e kuptoi urgjencën, pra punën e Ekzekutivit të Komunës për Arkivën e qytetit, këtu arkiva është punë specifike, sepse materiali arkivor duhet të ruhet dhe mirëmbahet, sipas standardeve ligjore, pra propozohet objekti i vjetër shkollorë në fshatin Pomozotin, ne e dijmë degradimin që i ka ndohur këtij objekti publikë, gjendjen momentale të tij, natyrën e këtij objekti, që ngërthen në vetë vete një pikë pyetje të madhe, gjendja fizike e këtij objekti të vjetër nuk i përshtatet objektit, që duhet të ridestinohet në objekt për Arkivën Komunale. Ky objekt për arsye të vjetërsisë së tij ndoshta edhe duhet të koservohet, kjo punë nuk shkonë kështu, nuk dihet cila do të jetë hapësira e shfrytëzimit të Arkivës Komunale, sa hapësirë do të mbetet për shkollën aty, nuk dihet asgjë për projektin në fjalë, kushtet e ndërtimit, kriteret, nuk dihet kostoja financiare e realizimit të këtij projekti me rëndësi publike. Këtu neve na tha Drejtori i Drejtorisë së Administratës se 60% e materialit arkivorë duhet të asgjësohet, kjo punë duhet të bëhet nga një

ekip profesional sipas kriterëve ligjore. Tani unë dua të rikujtoj juve, se objekti i Arkivës Komunale, është edhe premtim i dhënë nga ana e Ekzekutivit të Komunës. Institucioni i arkivës i ka rregullat e veta, për ruajtjen e materialit arkivorë, në thelb duhet ta kemi të qartë, menaxhimin zyrtarë, procedurën e shfrytëzimit, kushtet për ndërtimin e një objekti të ri, apo renovimin e këtij objekti, duhet të krijohen shumë kopje të materialit të njëjtë, në këtë proces ne duhet të përmbahemi, të zbatojmë në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore, këtu ndërrimi i destinimit të objektit, është vetëm fillim i një procesi, për të cilin ne nuk do të jemi të informuar, këtu do të veprohet njësoi, sikur me objektin e vjetër të Shtëpisë së Kulturës në fshatin Miradi e Epërme.

Mirsad Qyqalla: Unë nuk dua të përsëris fjalët e njëjta, ne qëndrimin tonë lidhur me këtë propozim e kemi dhënë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, kemi kërkuar sqarime nga Drejtori për Administratë. Ne kemi kërkuar edhe më herët që ky objekt shkollorë të trajtohet me urgjencë, tani ky objekt publikë, propozohet të ridestinohet në objekt për Arkivën Komunale, unë mendoj se investimi në këtë objekt duhet të fillon nga zero, nuk e kemi një konfirmim, a mund të funksionalizohet ky objekt në vend, ku duhet të ruhet materiali arkivorë, këtu duhet të mirret një mendim profesional i arkitektëve, për faktin se a është ky objekt i përshtatshëm për këtë destinim. Për këtë objekt dhe zhvillimin e dukurive negative aty ka reaguar edhe KFOR-i, është thënë se ky objekt, do të jepet në shfrytëzim Forcës së Sigurisë së Kosovës për të zhvilluar trajnimet e veta aty. Ndërrimi i destinimit nuk duhet të bëhet shkel e shko, pa një analizim të mirëfilltë, ndoshta këtë punë e bënë edhe presioni për shpenzimin e buxhetit, por unë jam skeptikë për realizimin e këtij projekti publikë, është mirë që këtu po mbyllet një vend ku zhvillohen dukuritë negative, por këtu nuk dihet kostoja financiare për renovimin e këtij objekti.

Hasan Ismajli: Unë këtu dua të them disa fjalë, por nuk dua të merrni këtë punë si diçka personale, unë nuk shpifë asnjëherë, por secilën çështje që e ngriti si diskutim, e bëjë me argumente, këtu është fjala se qytetarët me origjinë nga Lugina e Preshevës janë diskriminuar, sqarimi i Nënkyetarit të Komunës ka qenë se ata nuk kanë qenë të diskriminuar, sepse i kemi punësuar në arsim, komenti im ka qenë, se si mund të punësohet dikush në arsim pa dokumentacion. Me veprimet e këtij Ekzekutivi të Komunës të plasë barku, po tentohet që dokumentacioni arkivorë të dërgohet për ruajtje në një fshat, në periferi të komunës, sepse këta punojnë pa dokumentacion fare, u tha se këtu do të punësohen disa persona, do të bëhet sigurimi i tij, kjo është rrenë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë kërkoj që ju të mos e keqë përdorni foltoren e Kuvendit të Komunës, lidhur me Arkivën Komunale, por të flisni vetëm për temën, pa e ndërlidhur atë me çështje tjera.

Hasan Ismajli: Unë jam në temë i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, këtu Drejtori i Drejtorisë së Administratës për ri destinim të objektit, pa na dorëzuar neve certifikatën e pronës dhe ndarjen e saj, për shkollën dhe hapësirën për Arkivën Komunale, ne këtu nuk e kemi asnjë raport të inxhinierëve të komunës, për studimin e fizibilitetit për ndërtimin dhe përshtatjen e këtij objekti, i cili është i ndërtuar në vitet e pesë dhjeta, themelet e tij janë të ndërtuar me gurë, objekti është i pa izoluar, ngreh lagështi, aty parashihet të ruhen dokumentat e qytetarëve, që nuk pritset se do të asgjësohen. Unë i kam bërë dhjetë kërkesa për qasje në dokumente zyrtare dhe nuk kam marrë përgjigje, ndërsa e njëjta Drejtori e Komunës, po synon që materialin arkivorë të komunës prej gjashtë dhjetë e tre mijë banorë, po e dërgon në një fshat të komunës tonë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë me profesion jam teologë, andaj kërkoi nga ju të mos e keqë përdorni foltoren e Kuvendit të Komunës, andaj kërkoi që të për qëndroheni vetëm në temën për ri destinimin e këtij objekti.

Nënkryetari i Komunës: Kërkesa ime këtu është që ky propozim të mos votohet sot, as nga Grupi Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës, sepse për këtë çështje kërkohet një material më i plotë, sepse materiali që ruhet aty, do të jetë nën monitorimin e Arkivës së Kosovës, tjetër nuk e kemi një vlerësim profesional, se ky objekt publikë, a është në ruajtje të trashëgimisë kulturore dhe e fundit largësia nga qyteti, nuk është thelbi i problemit, por një theksim i juaji nga këndi i opozitës, aty do të punësohen pesë punëtorë, atje zona po shndërrohet në një qendër të institucioneve publike, atje është Njësia e Ndërmarrjes Publike 'Pastrimi', pastaj atje do të ndërtohet një objekt për Njësinë e Zjarrëfiksëve. Objekti në fjalë, nuk e dijmë, a do të rrenohet, apo do të restaurohet, u tha se në atë objekt ka shumë lagështi, deri në sqarimin e këtyre çështjeve, unë kërkoi që ky propozim të shtyhet për votim në njëren nga mbledhjet e ardhshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Dilema këtu është që të gjindet një sipërfaqe prej së paku dhjetë ari në qytet, për objektin e Arkivës Komunale, mirëpo unë personalisht jam i hapur për diskutimin e kësaj çështje me rëndësi publike.

Laureat Gojnovci: Unë kërkoi nga parafolësitë, që të kujdesen për ruajtjen e gjuhës parlamentare, këtu askush nuk duhet t'i thotë askujt se po rren, sepse për thëniet tuaja lidhur me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, sepse në atë rast është evidentuar e kundërta, duhet të kurseheni dhe të heshtni.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Secili prej juve duhet të ruhen nga termet, të jeni të kujdesshëm dhe të keni mirëkuptim për njëri tjetrin.

Vlonjat Hasani: Këtu vetë Nënkryetari i Komunës tha se këtu nuk kemi të bëjmë me Arkivën Komunale, por kemi të bëjmë me Arkivën e Qytetit, i cili kërkoi që kjo pikë të tërhiqet nga rendi i ditës, sepse propozimi nuk është i plotë.

Nënkryetari i Komunës: Arkiva e Qytetit duhet të ndërtohet në bazë të kriterëve dhe kushteve ligjore, që janë të standardizuara, këtu nuk duhet të keqëkuptohemi, këtu informimi lidhur me këtë çështje është i pamjaftueshëm, si për pozitën ashtu edhe për opozitën në Kuvendin e Komunës, dosja për këtë propozim duhet të plotësohet.

Hasan Ismajli: Unë kërkoi falje Nënkryetarit të Komunës, për diskutimin tim ku theksova se po rren, sepse ky fjalor nuk është pjesë e diskutimit tim, tërhiqem nga ky konstatim dhe kërkoi falje, u përmend këtu edhe diskutimi im lidhur me qëndrimin tim për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, unë vetëm kam thënë se aty kemi të bëjmë me një rast urgjentë, për këtë rast unë e kam thirrur Drejtoreshën për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, i kam dërguar një sms, kam kërkuar në kohën e pauzës, të kemi nga një mjek që e bënë trajtimin e pacientëve dhe asgjë me shumë, unë kam thënë se nëse nuk është kështu, unë do të kërkoi falje dhe do të jap dorëheqje nga mandate im zgjedhor.

Nënkryetari i Komunës: Unë e pranoi faljen dhe je i falur një qind herë, madje unë nuk jam ndier i fyerë fare, por ju duhet të kurseheni nga fjalori jo parlamentarë.

Dardane Sogojeva Shala: Ju tani këtu për aprovimin e propozimit për Arkivën Komunale nuk i keni votat, edhe unë kërkoi që të kompletohet materiali, sepse në Arkivën e Komunës, duhet të jenë edhe materialet e luftës tonë për liri, që duhet të ruhen.

Durim Hajra: Këtu u dhanë shumë vërejtje serioze nga kolegët tonë, këtu e kemi një pikë të rendit të ditës si propozim, me vetëm tre paragrafë, këtu nuk është e qartë se çka po propozohet, këtu nuk e kemi të definuar as pronën komunale që nevojitet për Arkivën Komunale, një propozim - vendim duhet ta ketë përmbajtjen e tij, nuk është kjo forma e duhur për ri destinimin e këtij objekti shkollorë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Këtu e kemi një propozim të mangët, andaj unë kërkoi nga propozuesi që ta na sqaron, se a është që ky propozim të tërhiqet nga rendi i ditës, nëse jo unë këtë propozim do të qes në votim.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të komunës, e qiti në votim 'Propozimin për ndërrimin e destinimit të objektit të vjetër të shkollës në fshatin Pomozotin, në objekt për Arkivën Komunale'.

U votua me: dymbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej dymbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës në mungesë të votave të pjesëmarrësve në votim, nuk e aprovon 'Propozimin për ndërrimin e destinimit të objektit të vjetër të shkollës në fshatin Pomozotin, në objekt për Arkivën Komunale'.

Koha e pushimit në kohëzgjatje prej një ore.

Pika e tretë (3) - Propozim për shqyrtimin e kërkesës për shpalljen e titullit 'Qytetari nderi' për vitin 2024 në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne tani e kemi për shqyrtim 'Propozimin e Ekzekutivit të Komunës për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi' për vitin 2024', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit që të na jap sqarime për propozimin në fjalë.

Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ky propozim ka ardhur më herët, unë jam kujdesur dhe e kam plotësuar biografinë e tij, me shënime shtesë, të cilën nuk e keni parur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, tani ua kam dorëzuar, atë e keni lexuar, andaj unë nuk kam çka t'i shtoi këtij propozimi të Ekzekutivit të Komunës, por ju ftoi që ta përkrahni për aprovim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ftoi propozuesin tjetër anëtarin e Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli që të na jap sqarime shtesë për propozimin e tij.

Hasan Ismajli: Unë pas marrjes së materialit të Kuvendit të Komunës, për këtë mbledhje, e kam lexuar atë dhe jam nxitur që ta jap propozimin tim që 'Qytetar nderi' i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024, të shpallet z. Gani Bajrami, i cili është një veprimtarë me kontributin e tij në Komunën e Fushë-Kosovës. Pas leximit të biografisë së propozimit të Ekzekutivit të Komunës, unë e kam përgatitur propozimin tim dhe e kam dorëzuar para mbajtjes së mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, unë nuk e kam parë ndonjë kontribut të theksuar në Fushë-Kosovë, të kandidatit të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës z. Tasim Brovina, ka qenë një material i mangët prej dy faqeve. Kandidati i propozuar nga unë ka dhënë kontributin e tij në komunën tonë, ka qenë anëtarë dhe themelues i teatrit amator 'Qëndresa' në Fushë-Kosovë, aktor i teatrit, autor i dy librave, e ka vëllaun dhe babain e vrarë në luftë, që janë martirë të lirisë, e kam paraqitur në

biografinë e tij të cilën ju e keni përpara dhe mund ta lexoni vetë, ndërsa kandidati tjetër ka qenë mësues i Edukatës Fizike, thuhet në shkresa se ka dhënë kontributin e tij në themelimin e Klubit të Ping-pongut 'Kosovari' në fshatin Bardh i Madh, pastaj në disa mandate ka qenë sekretar në bashkësinë Lokale në Prishtinë, ku dihet si janë zgjedhur këta nëpunës në atë kohë, me direktiva të partisë në pushtetit, në biografinë e tij thuhet, thuhet se e ka dhënë mësim në shkollën e quajtur 'Vlladimir Iliç Lenini' në një fshat të Komunës së Rahovecit dhe me pagën e tij të parë i ka blerë nënës së tij një thes me miell, ju lexone vetë propozimin në fjalë dhe vetë vendosni.

Laureat Gojnovci: Ne tani para vetës në shqyrtim i kemi dy propozime, njëri është: 'Propozimi i Ekzekutivit të Komunës', që ka ardhur më herët në shqyrtim dhe propozimi tjetër është: 'Propozimi i kolegut tonë anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli', të dyja këto propozime e meritojnë të trajtohen dhe shqyrtohen në Kuvendin e Komunës, që të shpallen dhe nderohen me titullin 'Qytetar nderi' i Komunës së Fushë-Kosovës, ne e përkrahim për këtë vitë 'Propozimin e Ekzekutivit të Komunës së Fushë-Kosovës', që me këtë titull të nderohet z. Tasim Brovina, nuk kemi asgjë kundër propozimit të z. Gani Bajrami për titullin 'Qytetar nderi', e njohim biografinë dhe kontributin e tij, është një personalitet i shquar, por ai mund të shpallet dhe nderohet me këtë titull në një të ardhme të afërtë, sepse e meriton këtë çmim.

Doruntina Jashari: Atëherë këtë çështje e sqaroi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës shumë drejtë, ne në shqyrtim i kemi dy propozime, cila është këtu puna e Komisionit Komunal për përzgjedhjen e kandidatit për titullin 'Qytetar nderi' i Komunës së Fushë-Kosovës, pyetja ime është a mund ne të votojmë për të dy kandidatët e propozuar.

Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport: Rregulloren për ndarjen e çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera, e keni në ueb-faqën e komunës, këto personalitete nuk zgjidhen nga Komisionet Komunale, këtu propozimet jepen nga Ekzekutivi i Komunës, por mund të jepen edhe nga të tjerët, ne përzgjedhjen e qytetarëve të nderit e bëjmë për më shumë se pesëmbëdhjetë vite, unë e njoh edhe personalisht, e vlerësoj lartë kontributin e z. Gani Bajrami, ai e meriton këtë titull, po sot nuk është titulli i fundit që aprovohet në Kuvendin e Komunës, unë ju ftoi që ta përkrahni propozimin e dhënë nga Ekzekutivi i Komunës.

Hasan Ismajli: Askush neve nuk na ka thirrur që të vlerësojmë kontributin e këtyre dy personaliteteve, kandidati i Ekzekutivit të Komunës është punëtorë i arsimit, me pagë dhe ka punuar në shkollën tonë 'Zenel Salihu' në fshatin Bardh i Madh vetëm katër vite, si arsimtarë i Edukatës Fizike, ka dhënë kontribut në themelimin e klubit të Ping-pongut dhe ka qenë sekretar në Bashkësinë Lokale, ku njerëzit aty janë zgjedhur me direktiva, kjo punë është hajgare, ne si komunë tani po pretendohet dhe thuhet se do të kemi 63 mijë banorë, andaj është në dinjitetin e këtij Kuvendi të Komunës, që të bëjë përzgjedhjen e z. Gani bajrami dhe ta nderon me titullin 'Qytetar nderi' i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024'.

Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport: Edhe njëherë dha sqarime shtesë për biografinë e propozimit të Ekzekutivit të Komunës për titullin 'Qytetar nderi', ku theksoi se ai ka punuar pesëmbëdhjetë vite si arsimtar i Edukatës Fizike.

Mirsad Qyqalla: Tani ne këtu u zgjatëm shumë, drejtori e sqaroi propozimin e tij për përzgjedhjen e z. Tasim Brovina, ku është përmirësuar teksti për biografinë e tij, por aty është një absurd i llojit

të vetë, ku thuhet se në vitet e tetëdhjeta, kur ka punuar i ka blerë nga paga e tij, nënës së tij një thes miell, u sqarua edhe kontributi i tij si mësues, por edhe për sportin, tani e kemi edhe propozimin tjetër që po ashtu u sqarua këtu, ju neve po na vendosni në situata të vështira pa nevojë, së paku këtu është dashur ta kemi një harmonizim dhe dakordim për personalitetin që do ta zgjidhnim, sikur ka qenë rasti i vendimit tonë vitin e kaluar, ku të gjithë kemi qenë unik në procesin e vendim marrjes. Ne nuk jemi këtu që të mohojmë vlerat dhe kontributin e asnjërit prej këtyre dy individëve, por ky shembull kërkojmë që të mos përsëritet herave të tjera.

Shpend Bardiqi: Unë pas leximit të propozimeve të dhëna, biografia e kandidatit të propozuar nga kolegu ynë z. Hasan Ismajli mu dukë se është më bindëse, e përgatitur mirë, ndërsa i tërë Ekzekutivi i Komunës, me personel administrativ e ka përgatitur një biografi kaq jo serioze dhe të dobët, ne jemi që kësaj radhe, të përkrahjet propozimi i dhënë nga z. Hasan Ismajli.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani ne i kemi dy propozime unë i kam lexuar të dyjat, këtu tani do të shpreh qëndrimin tim si përfaqësues i Partisë së Drejtësisë dhe unë nuk do të marrë pjesë fare në votim për asnjërin propozim, personalisht unë do ta përkrahja propozimin për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi' i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024', propozimin për z. Gani Bajrami, sepse dihet kontributi i tij, është i përgatitur më mirë edhe si propozim, por mua kjo punë më lidh edhe emocionalisht, sepse unë rri me këta njerëz, i kam edhe unë dy të vrrarë në familjen time, njëjtë sikur janë edhe anëtarët e familjes Bajrami, andaj dua të ju them sinqerisht se tani unë po ndihem në siklet dhe nuk mund të marrë pjesë në votim e asnjërit propozim tani këtu.

Durim Hajra: Ne tani këtu i kemi dy propozime, këtu është një zgjidhje e keqe, por propozimet duhet të hidhen në votim, sepse i kemi shqyrtuar secilën prej tyre.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin e dhënë nga Ekzekutivi i Komunës për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi' i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024 për kandidatin z. Tasim Brovina'.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim', gjithsej trembëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës në mungesë të votave të pjesëmarrësve në votim nuk e miraton 'Propozimin e Ekzekutivit të Komunës për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi' i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024 për kandidatin z. Tasim Brovina'.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim edhe 'Propozimin e dytë për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi' i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024 për kandidatin z. Gani Bajrami, të propozuar nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli'.

U votua me: shtatë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim', gjithsej shtatë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës në mungesë të votave të pjesëmarrësve në votim nuk e miraton 'Propozimin për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi' i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024 për kandidatin z. Gani Bajrami, të propozuar nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli'.

Pika e katërt (4) - Propozim për formimin e Komisioneve, për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin e Drejtorisë së Arsimit për formimin e Komisioneve, për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës', sipas dispozitave ligjore të udhëzimit administrativ të Ministrisë së Arsimit, propozimet e kësaj natyre janë të njohura për ne, sepse janë shqyrtuar edhe më herët në mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Hap diskutimin.

Fisnik Sllamniku: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani këtu dispozitat ligjore janë të qarta, ju i keni para vetës propozimet për secilin Komision për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, tani drejtoresha e shkollës së fshatit Lismir shkon në pension, drejtori i shkollës 'Daut Bogujevci' në Fushë-Kosovë, e ka ofruar dorëheqjen e tij për arsye personale dhe shëndetësore, e kemi edhe shkollën e re, çerdhen e re, sipas dispozitave të udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, dy anëtarë të Komisionit duhet të propozohen nga Drejtoria e Arsimit dhe të aprovohen nga Kuvendi i Komunës, njëri duhet të jetë nga Drejtoria e Arsimit dhe tjetri duhet të jetë drejtor i shkollës me përvojë pune, pastaj anëtari i tretë këtu e ka vendin e tij, është përfaqësuesi i Ministrisë që delegohet prej tyre, anëtarët tjerë janë në cilësinë e vëzhguesit sipas udhëzimit, kandidatët e propozuar për këto komisione ju i njohni, përfaqësuesin e prindërve e zgjedh Këshilli drejtues i shkollës për një vitë, këtu është edhe përfaqësuesi i mësimdhënësve, kjo çështje është ligjore dhe procedurale, andaj unë në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozoi që të përkrahet për aprovim 'Propozimi i Drejtorisë së Arsimit për formimin e pesë Komisioneve, për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës', sipas dispozitave ligjore të udhëzimit administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit.

Durim Hajra: Nëse Drejtoria e Arsimit e merr këtë çështje si shumë serioze, atëherë ata janë jashtë planifikimit, atëherë propozimi për këto komisione ka ardhur pas shpalljes së konkursit publikë për drejtor të çerdhes, ndërsa është dashur të jetë ndryshe, sepse konkurset për çerdhen publike janë shpallur, andaj ju nuk jeni duke i respektuar procedurat që parashihen me ligje.

Migjen Kolshi: Këtu aspekti procedural është vetëm në letër, sepse si zgjidhen drejtorët dhe zëvendës drejtorët e shkollave tona të gjithë e dijme, një praktikë e njëjtë është në nivel vendi, jo vetëm në komunën tonë, sepse me aspektin partiak është zgjedhur edhe drejtori që po ushtron dhunë në shkollë z. Fidan Hasani ndaj nxënësve të fshatit Harilaç dhe rasti i tij është edhe në Policinë e Kosovës, madje ju për këtë rast po heshtni, i përzgjedhuri i juaj si drejtor shkollë, është edhe bashkëvendas edhe i Kryetarit të Komunës.

Hasan Ismajli: Unë e kuptoi arsyetimin politikë që po e bëni ju i nderuari z. Fisnik Sllamniku, por si do të formohet Komisioni për shkollën e re, ku atje nuk është zgjedhur ende Këshilli i Prindërve, sepse shkolla është në ndërtim tani, si do veprohet me institucionin e çerdhes së fëmijëve po ashtu, apo kjo punë bëhet vetëm me një tik dhe përfaqëson Këshilli i Prindërve nga shkolla 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë, ju nuk do të mund ta emëroni as shkollën e re me ndonjë emër të saj, sepse nuk i plotëson kushtet ligjore të hapësirës për të qenë shkollë, do të jetë një Aneks 3, i shkollës 'Mihal Grameno', sikur janë edhe dy anekset tjera dhe duhet ta zgjidhni nga prapë një zëvendës drejtor, njësoi është puna edhe me çerdhen e re.

Fisnik Sllamniku: Unë dua ta paraqes këtu para juve edhe një fenomen tjetër që është duke ndodhur në shkollë, është marrë nga lojërat e tik-tokut dhe nxënësit po e lidhin me ndjena, janë

disa raste deri tani, kërkojmë një trajtim serioz të kësaj pune, që është duke ndodhur me disa nxënës në shkollën 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin e Drejtorisë së Arsimit për formimin e pesë Komisioneve për përzgjedhjen e drejtorëve në Institucionet Edukativo-Arsimore, sipas dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit'.

U votua me: katërbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katërbëdhjetë pjesëmarrës në votim, nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve pjesëmarrës në votim e aprovoi 'Propozimin e Drejtorisë së Arsimit për formimin e pesë Komisioneve për përzgjedhjen e drejtorëve në Institucionet Edukativo-Arsimore, sipas dispozitave të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit' dhe mori:

V E N D I M

1. Për zgjedhjen e anëtarëve të pesë Komisioneve për rekrutimin e Drejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës.
 - 1.1 Për zgjedhjen e Komisionit për rekrutim për Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Lismiri', në fshatin Lismir në përbërje prej tre anëtarëve:
 - 1.1.1 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit;
 - 1.1.2 Vlora Berjani - Zyrtare e Lartë në Drejtorinë e Arsimit - Kryetare e Komisionit;
 - 1.1.2 Gëzim Berisha - anëtar i Komisionit, drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Laura Scotti', në fshatin Graboc i Poshtëm;
 - 1.1.3 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve në nivel komune;
 - 1.1.4 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve - në cilësinë e vëzhguesit dhe
 - 1.1.5 Një anëtar nga Këshilli i Mësimdhënësve - në cilësinë e vëzhguesit.
- 1.2 Për zgjedhjen e Komisionit për rekrutim në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Daut Bogujevci', në Fushë-Kosovë në përbërje prej tre anëtarëve:
 - 1.2.2 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit;
 - 1.2.3 Vlora Berjani - Zyrtare e Lartë në Drejtorinë e Arsimit - Kryetare e Komisionit;
 - 1.2.4 Esad Simnica - anëtar i Komisionit, drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Laura Scotti', në fshatin Graboc i Poshtëm;
 - 1.2.5 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve në nivel komune;
 - 1.2.6 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve - në cilësinë e vëzhguesit dhe
 - 1.2.7 Një anëtar nga Këshilli i Mësimdhënësve - në cilësinë e vëzhguesit.
- 1.3 Për zgjedhjen e Komisionit për rekrutim në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët - Shkolla e re në Fushë-Kosovë në përbërje prej tre anëtarëve:
 - 1.3.2 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit;
 - 1.3.3 Vlora Berjani - Zyrtare e Lartë në Drejtorinë e Arsimit - Kryetare e Komisionit;
 - 1.3.4 Salih Jashanica - anëtar i Komisionit, drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Zenel Salihu', në fshatin Bardh i Madh;
 - 1.3.5 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve në nivel komune;
 - 1.3.6 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve - në cilësinë e vëzhguesit dhe

- 1.3.7 Një anëtar nga Këshilli i Mësimdhënësve - në cilësinë e vëzhguesit.
- 1.4 Për zgjedhjen e Komisionit për rekrutim e Institucionit Parashkollorë ‘Gëzimi Ynë’ Fushë-Kosovë në përbërje prej tre anëtarëve:
 - 1.4.2 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit;
 - 1.4.3 Elmije Grajçevci Zymberi - Shefe e Drejtorisë së Arsimit - Kryetare e Komisionit;
 - 1.4.4 Nexhmedin Rexhepi - anëtar i Komisionit Zëvendës drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët ‘Mihal Grameno’ - Aneksi II, në Fushë-Kosovë;
 - 1.4.5 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve në nivel komune;
 - 1.4.6 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve - në cilësinë e vëzhguesit dhe
 - 1.4.7 Një anëtar nga Këshilli i Mësimdhënësve - në cilësinë e vëzhguesit.
- 1.5 Për zgjedhjen e Komisionit për rekrutim në Institucionin Parashkollorë për Çerdhen e re në Fushë-Kosovë në përbërje prej tre anëtarëve:
 - 1.5.2 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit;
 - 1.5.3 Elmije Grajçevci Zymberi - Shefe e Drejtorisë së Arsimit - Kryetare e Komisionit;
 - 1.5.4 Sadri Emini - anëtar i Komisionit Zëvendës drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët ‘Mihal Grameno’ - Aneksi I në Fushë-Kosovë;
 - 1.5.5 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve në nivel komune;
 - 1.5.6 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve - në cilësinë e vëzhguesit dhe
 - 1.5.7 Një anëtar nga Këshilli i Mësimdhënësve - në cilësinë e vëzhguesit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në vazhdim sqaroi se Komisioni monitorues me anëtarë të Kuvendit të Komunës, që po kërkohet nga Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje, nuk parashihet me dispozitat ligjore të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit.

Mirsad Qyqalla: Ky Komision monitorues me përfaqësues të subjekteve politike në Kuvendin e Komunës, është kërkuar nga ne edhe në rastet e kaluara, por nuk është përkrahur nga shumica në Kuvendin e Komunës, ky komision nuk ka asnjë rol në vendim marrje, do ta këtë vetëm cilësinë e vëzhguesit të procesit të për zgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave.

Në vazhdimin e saj të rrjedhës mbledhja e Kuvendit të Komunës, u ndërpre nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, në mungesë të kuorumit në orën 13:45 minuta, meqë nga mbledhja pa ndonjë paralajmërim, u larguan anëtarët e Kuvendit të Komunës nga shumica e Kuvendit të Komunës, në rastin konkret anëtarët e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Vazhdimi i mbledhjes së ndërprerë të datës 30.05.2024, me datën 18.06.2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje dhe sqaroi se tani jemi në vazhdimin e mbledhjes së ndërprerë me datën 30.05.2024, ku janë përfunduar katër pika të rendit të ditës, ndërsa tani do të fillojmë nga pika e pestë e rendit të ditës.

Pika e pestë (5) - Rishqyrtimi i vendimit Nr. 08, të datës 07.02.2024 për shndërrimin e tokës bujqësore, në tokë ndërtimore për palën Gëzim Bullatovci.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi në rishqyrtim, ‘Vendimin Nr. 08, të datës 07.02.2024 për shndërrimin e tokës bujqësore, në tokë ndërtimore për palën Gëzim Bullatovci’, anëtarët e Komitetit për Politikë e Financa e dinë sqarimin e Ekzekutivit të Komunës lidhur me

këtë çështje, ju e keni lexuar materialin në fjalë, e dini natyrën e kontestimit që e bënë Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas kthimit të vendimit në rishqyrtim nëpërmjet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, pas një periudhe me vonesë tre mujore, ne vendimin tonë pas kalimit të afateve ligjore prej një muaji nga dita e dorëzimit për shqyrtim të ligjshmërisë, e kemi publikuar në ueb-faqën e komunës. Tani meqë vendimi është konsideruar i kundërligjshëm, unë e qes në votim ‘Kërkesën për shfuqizimin e Vendimit Nr. 08, të datës 07.02.2024 për shndërrimin e tokës bujqësore, në tokë ndërtimore për palën Gëzim Bullatovci’.

U votua me: pesë vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë pjesëmarrës në votim ngë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se ‘Kërkesa për shfuqizimin e Vendimit Nr. 08, të datës 07.02.2024 për shndërrimin e tokës bujqësore, në tokë ndërtimore për palën Gëzim Bullatovci’, në mungesë të votave nuk kalon dhe vendimi mbetet në fuqi, pas rishqyrtimit në Kuvendin e Komunës.

Pika e gjashtë (6) - Informatë për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi si pikë të rendit të ditës ‘Informatën për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2025’, e cila ka qenë në ‘Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës’, por askush nga Ekzekutivi i Komunës nuk është këtu tani për sqarime, ju e patë që organizimi ynë për dëgjimin buxhetore për ‘Kornizën Afatmesme Buxhetore komunale për vitet 2025-2027’, i thirrur nga unë si organizatorë bashkë me anëtarët e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komuniteter dështoi, por unë ju rikujtoi juve, se ne do ta mbajmë edhe një dëgjim buxhetor si Kuvend i Komunës, në fund të muajit gusht apo në fillim të muajit shtator 2024.

Pika e shtatë (7) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të parashtrajnë pyetje për Ekzekutivin e Komunës.

Laureat Gojnovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam dy pyetje për Ekzekutivin e Komunës, njëra ka të bëjë me ngastrën kadastrale, që është shqyrtuar në mbledhjen e kaluar për Shkollën e Futbollit, ku është aprovuar në Kuvendin e Komunës propozimi i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, pyetja ime është ku ka mbetur procesi pas dërgimit të vendimit tonë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa nga Drejtoria e Infrastrukturës për unazën e rrugës në fshatin Lismir janë të parapara 50,000.00€, kur do të fillon ky projekt publikë, prej Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit kërkojmë që puna në rregullimin e ndriçimit publik, të kryhet në gjithë territorin e komunës sipas një dinamike të arsyeshme kohore të punës në teren.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne tani këtu jemi shndërruar në teatër me mos prezencën e Drejtorëve të Drejtorateve të Komunës, për kundër premtimit të dhënë sipas dakordimit në takim me Nënkryetarin e Komunës, por këtu në sallën e Kuvendit të Komunës, po shihet se kjo punë është jo serioze. Mbledhja e datës 30 maj 2024, është ndërprerë në mënyrë arbitrare nga veprimet e shumicës në Kuvendin e Komunës, ai ka qenë një veprim i pa sinqertë nga ana e tyre. Unë tani për hirë të respektit ndaj qytetarëve të komunës tonë, por jo edhe ndaj Ekzekutivit të Komunës, do të përsëris disa pyetje, që janë edhe para dy muajve, të cilat tani edhe

nuk janë relevante më, tani për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit e kemi pyetjen e parë, për mbjelljen e drunjëve dekorativ, të cilët janë duke u mbjellur në rrugën 'Dardania' dhe rrugët tjera të kësaj lagje, këta drunjë janë tharë qysh në fillim të realizimit të këtij projekti, janë hapur disa gropa, nuk janë rrethuar dhe siguruar fare nga punëkryesi, më shumë se gjysma e këtyre pemëve janë jo adekuate dhe jo cilësore për një qytet. Pyetja e dytë ka të bëjë me pastrimin e varrezave që ka filluar në dy fshatra të komunës, propozojmë që të bëhet edhe në fshatrat tjera, po ashtu duhet të pastrohen edhe varrezat e qytetit. Pyetja e tretë ka të bëjë me riparimin e rrugëve, që ka filluar të bëhet tani në qytet me asfalt, është e pakuptueshme kjo mënyrë e punës nga ana e juaj, një gropë mbyllet, por shkaktohen shumë probleme, disa nuk mbyllen, këtu duhet të jetë më këmbëngulës menaxheri i kontratës, sepse në rrugën 'Dardania' dhe 'Pajazit Islami', janë mbyllur kanalet e rrjetit atmosferik të kanalizimeve dhe ka shumë telashe në këto rrugë. Pyetja e katërt është për Drejtorin e Drejtorisë së Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës, lidhur me dokumentacionin për pronat publike komunale, që neve nuk na jepet, ky hyn edhe pyetja jonë për ndërrimin e pronarit nga prona publike në pronë private, na është thënë se për këtë çështje ka një vendim të Gjykatës, por ai neve nuk na është dorëzuar, nëse nuk e kemi një informim për këtë lëndë, ne do të procedojmë në gjykatë, do të presim edhe pak ndoshta, por jo në pa kufi. Lidhur me katin e dytë të komunës, aty punimet nuk janë bërë si duhet, punëtorët e Administratës së Komunës aty janë vendosur para kryerjes së punëve, aty nuk janë kryerë as 40% të punës sipas paramasës dhe paralogarisë së projektit në fjalë. Pyetja tjetër ka të bëjë me Drejtorin e Drejtorisë së Inspektoratit, lidhet me zhurmën në qytet, ku problemet vazhdojnë nga lokale e ndryshme në shumë zona, unë dua ta dijë sa gjopa janë shqiptuar për pronën e uzurpuar në lagjen e Dardanisë, sepse uzurpimi i pronës publike është bërë i pa përbalueshëm. Ndërsa tani i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, nuk do të parashtroni pyetje për Drejtoritë e Arsimit dhe Shëndetësisë, sepse drejtorët nuk janë prezentë në mbledhje.

Mirsad Qyqalla: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani ju i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, në takimin tonë të përbashkëtë me përfaqësues të subjekteve politike të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lëvizjes Vetëvendosje, Partisë Demokratike të Kosovës dhe subjekteve tjera me Nënkryetarin e Komunës, jemi dakorduar që të kemi një prezencë të kënaqshme të Drejtorëve të Drejtorateve në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, ky dakordim nuk po respektohet, andaj tani jemi këtu, në mbledhjen e kaluar dolën anëtarët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, tani cili është kuptimi dhe qëllimi i vazhdimit të kësaj mbledhje, kjo po shihet sikur një hakmarrje e shumicë këtu, këtu po shihet qartë kush nuk po e mbanë fjalën, këtu janë lojëra politike, ju e keni ftuar vazhdimin e mbledhjes dhe këtu e keni 80% të opozitës, ndërsa mbledhjen e Kuvendit të Komunës e saboton Ekzekutivi i Komunës, nuk jemi në rregull sepse edhe ne kemi obligime, mos na detyroni që të ndjekim rrugë tjera, këtu tani erdhën katër apo pesë drejtor, duhet të ketë një përgjegjësi për fjalën e dhënë.

Hasan Ismajli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani prezentë i kemi vetëm dy drejtor komunal, të tjerët u larguan nga salla. Tani unë do të parashtroni një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, lidhur me shpalljen e listës së përfituesve të subvencioneve nga thirrja publike e fundit e kësaj drejtorie, unë nuk e dijë a është bërë kjo punë nga drejtori apo nga komisioni, përgjegjësia e kujt është, por në këtë rast janë shkelur shumë nene, edhe të 'Rregullores Komunale për ndarjen e subvencioneve', e cila është e miratuar në vitin 2013, edhe të 'Rregullores së Ministrisë së Financave për përkrahjen e Organizatave Jo Qeveritare', e cila është e vitit 2017,

te rregullorja e Ministrisë së Financave, është shkelur neni 6, neni 13, që qartësojnë mënyrën e veprimit, pastaj neni 7, neni 8, neni 9, neni 10, neni 12, neni 15, neni 18 dhe neni 20, sa për sqarim në nenin 6, thuhet se shuma e përfituesit duhet të jetë deri në pesë mijë euro, ndërsa për disa individë janë është shuma e mjeteve financiare prej tetë mijë apo nëntë mijë euro, unë pres që deri në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, të më dorëzohet një sqarim për këtë çështje, ose kjo lëndë për ndarjen e subvencioneve do të dërgohet nga subjekti ynë politikë në krime ekonomike, sepse këtu kemi keqëpërdorim të pozitës zyrtare, sepse janë shkelur shumë nene, madje edhe të Rregullores Komonale të vitit 2013, ku janë hapur aplikimet nga Komisioni Komunal, për financimin e Organizatave Jo Qeveritare dhe Individëve, po ashtu duhet të formohet edhe një Komision mbikëqyrës, pastaj një Komision për ankesa, të cilët duhet ta bëjnë punën e vetë, të ketë një monitorimin e shpenzimeve, sepse këtu ka një keqëpërdorim dhe familjarizën, këtu përfitues është edhe z. Sejdi Gashi, i cili më herët ka qenë edhe te unë në Degën e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ma kishin dërguar atëherë, me profesion është me gjuhë shqipe, këtu në listën e përfituesve ka edhe disa emra të tjerë, që nuk e kanë të merituar përkrahjen financiare që e kanë marrë nga komuna, andaj unë kërkoi sqarime për këto mjete financiare, të ndara nga buxheti i komunës. Pyetja tjetër ka të bëjë me dy ngastrat kadastrale, që në mbledhjen e kaluar janë caktuar si lokacion për Shkollën e Futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël, që nga drejtori na është thënë se me Hartën Zonale të Komunës, kjo zonë është e destinuar për sport, unë nuk po dua të them po folni të pa vërteta, sepse në një pjesë të njëres ngastër kadastrale, është ndarë për kopshtin botanikë, andaj unë deri në fund të mbledhjes kërkoi përgjigje lidhur me këtë çështje me rëndësi publike.

Vlonjat Hasani: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë i kam dy ankesa, që në fakt janë edhe shqetësime të banorëve të fshatit Miradi e Epërme dhe Miradi e Poshtme, ku janë vendosur disa pengesa në rrugë, jashtë rregullave të komunikacionit, me një distancë prej pesë dhjetë metra, ku edhe vetë Drejtoria e Inspektoratit e ka pohuar se janë thyerë rregullat, sepse ato janë vendosur pa pëlqimin e tyre, sikur po duket nga një numër i bizneseve të fuqishme dhe me emër. Po ashtu pyetja tjetër ka të bëjë me largimin e taksive ilegal nga rruga '17 Shkurti' në Fushë-Kosovë. Për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, e kemi një kërkesë të penzionerëve për lirim nga taksat e biletës së trafikut urban, ose subvepcionimin e biletave të tyre, sepse unë jam takuar me disa operatorë që operojnë në komunën tonë. Pyetja tjetër është një shqetësim për largimin e një pjese të konsiderueshme të punëtorëve të Administratës Komonale në orën 15:00h nga puna, pra një orë para kohe, ne mendojmë se dikush për këto veprime duhet të ndëshkohet dhe sanksionohet me masa disiplinore, sepse kjo punë është e përditshme në komunën tonë, po kemi edhe punëtorë shumë të përgjegjshëm që e respektojnë orarin e punës. Po ashtu rruga 'Dëshmorët', në fshatin Miradi e Epërme është e dëmtuar dhe qytetarët po kanë shumë vështirësi, andaj kërkojmë që në riparimin e kësaj rruge të intervenohet nga institucionet komunale.

Migjen Kolshi: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Kjo situatë në të cilën ka ardhur Kuvendi i Komunës, është e planifikuar mirë, këtë gjendje unë nuk e kam hasur asnjëherë në mandatet e kaluar, ky janë tre mandate, ku kanë qenë edhe kolegët tona znj. Aida Alimi dhe znj. Vjollca Konjusha, por edhe të tjerët, ky marrëveshja e dakorduar e Shefave të Grupeve Parlamentare është duke u shkelur. Klubi i Futbollit 'Fushë-Kosova' është para shuarjes, andaj unë ju lus që si Kuvend i Komunës, por edhe si Ekzekutiv i Komunës, ta gjejnë një zgjidhje, sepse edhe komunat tjera po ndajnë donacione në shuma të mëdha për klubet e tyre sportive, e sidomos për futbollin, që është

më masovik, ku përfshihet një numër më i madh i rinisë, andaj meritojnë të përkrahen nga institucionet komunale, por edhe nga donatorët tjera, që e zhvillojnë veprimtarinë e tyre ekonomike dhe afariste në qytetin tonë. Nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, kërkojmë që të intervenohet në mirëmbajtjen e ndriçimit publik në fshatin Harilaç, i cili është jo funksional. Te shpërndarja e subvencioneve nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit z. Burim Berisha me shumën e përfituar të mjeteve financiare prej: 2,300.00€, ka bërë organizimin e garave në shkolla, kjo e paraqet një konflikt të interesit, sepse ai është edhe Nënkryetar i nëndegës së Lidhjes Demokratike të Kosovës në fshatin Bardh i Madh, po ashtu për një festival që mbahet në fshatin Harilaç, është ndarë një shumë e mjeteve financiare prej: 9,500.00€, në vend se këto mjete financiare të ndaheshin si ndihmë për klubin e futbollit 'Fushë-Kosova', atje është duke u degjeneruar rinia në këtë festival. Për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit e kam një pyetje lidhur me sjelljen jo etike të Drejtorit të Shkollës 'Bajram Curri', z. Fidan hasani, i cili ka ushtruar dhunë ndaj një nxënësi pesëmbëdhjetë vjeçar të shkollës së fshatit Harilaç, gjatë një eskurzioni, kërkesa ime këtu është që të ndërmerren masa disiplinore nga Drejtoria Komunale e Arsimit, andaj unë po e ngriti këtë punë si një shqetësim, sepse ky drejtor i ka radhur nxënësit e tri paraleleve të fshatit Harilaç, ku rast ka qenë edhe në media dhe për këtë sjellje të tij ka edhe dëshmitar, sepse ku drejtor e ka një sjellje të tillë sidomos ndaj nxënësve të fshatit Harilaç.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne tani këtu i kemi dy drejtor prezentë z. Ilir Hasani dhe z. Amir Bullatovci, jam dakort me deklarinimin e z. Durim Hajra dhe z. Mirsad Qyqalla, për mos respektimin e dakordimit tonë si Shefa të Grupeve Parlamentare me Nënkryetarin e Komunës, unë e kam bërë angazhimin tim, por po vërehet se kjo punë nuk ecë mirë, por ju duhet ta dini se në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, pushtetet janë të ndara dhe ne duhet të bëjmë punën tonë, diskutimet tona regjistrohen në ekstraktin e procesverbalit, andaj unë i ftoi drejtorët prezentë, që nëse kanë ndonjë përgjigje për të dhënë, në pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit të Komunës ta marrin fjalën.

Drejtori për Administratë: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Tani çështja e ngritur nga anëtarët e Kuvendit të Komunës z. Vlonjat Hasani, për largimin e punëtorëve të Administratës Komunale në orën 15:00h nga puna, unë kur kam ardhur këtu e kam gjetur një praktikë jo të mirë, këtu puna me palë fillon në orën 09:00h dhe vazhdon deri në orën 15:00h, kjo punë nuk është në menaxhimin tim të drejtë për drejtë, por të Udhëheqësve të Sektorëve, orari i punës është nga ora 08:00h deri në orën 16:00h, unë para dy muajve e kam zgjatur kohën e punës me palë nga ora 09:00h deri në orën 15:30 minuta, ndërsa gjysëm orë mbetet për punë administrative dhe përgatitjen e raporteve të punës ditore, qëndrimi i punëtorëve në punë verifikohet përmes sistemit elektronik.

Vlonjat Hasani: Tani jemi në prag të kohës së ardhjes së mërgimtarëve nga vendet përendimore, këto ka punëtorë që e kanë koeficientin tetë dhe nëntë, kanë paga të mirë, andaj orari i punës duhet të respektohet, të gjithë të punësuarit duhet të jenë të përgjegjshëm për orarin e punës, ndaj atyre që e shkelin orarin e punës duhet të mirren masa disiplinore sipas legjislacionit në fuqi, shërbimet administrative duhet të ofrohen, sepse njerëzit që i kërkojnë ato janë në marrëdhënie pune dhe duhet të marrin kohë nga puna e tyre, për të ardhur në komunë për marrjen e ndonjë dokumenti zyrtar që ju duhet, andaj ju duhet të rregulloni këtë punë.

Drejtori për Administratë: Kjo është një çështje operationale e veprimit, ne vitin e kaluar e kemi zgjatur orarin në Sektorin e Gjendjes Civile.

Pika e tetë (8) - Të ndryshme.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që ta marrin fjalën nëse e kanë ndonjë çështje për diskutim.

Hasan Ismajli: Unë këtu dua ta paraqes një shqetësim jo timin personal, por për një familjar timin dhe trajtimin jo me dinjitet të dëshmorëve të kombit, ku ne për festa e kemi në traditën tonë të bëjmë homazhe në varreza, andaj është në dinjitetin tonë, mirëmbajtja e varrezave dhe respektimi e perkujtimit të dëshmorëve, që kanë rënë për lirinë e vendit tonë, unë këtu e kam fjalën për dy dëshmor, në mesin e tyre është edhe vëllau im dëshmor, që ka rënë në altarin e lirisë si ushtar i vrarë në vitin 1988 dhe me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është shpallur dëshmor, pse ju dega e Lidhjes Demokratike të Kosovës, në Fushë-Kosovë, po bëni dallime, me apo pa vëtdije, unë nuk dua ta përdorë këtë rast për asgjë, nuk e kam përdorur asnjëherë në jetën time, por kjo duhet të jetë çështje e ndërgjegjes dhe dinjitetit për dëshmorët e rënë për liri, këtu nuk ka bajraktarizëm, vëllau im është vrarë herët, atëherë kur është vrarë në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare është një ndër dëshmoret e para znj. Shukrie Obërtinca nga fshati Lismir, tek Xhamia e Llapit, ajo si protestuese ka qenë në rendin e parë, pastaj në atë kohë është vrarë edhe ushtari z. Abedin Krasniqi nga fshati Bardh i Vogël, andaj unë ju ftoi të mos veproni në këtë mënyrë jo të dinjitetshme, por të respektoni dëshmorët, duke filluar nga Nënkryetari i Komunës, pastaj Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, respekti për ta është nderë dhe kulturë, sepse ata kanë derdhur gjakë, për lirinë që ne të gjithë e gëzojmë sot, ne duhet t'i respektojmë të gjithë njësoi, unë ju siguroi se unë asnjëherë nuk e kam përdorur vëllaun tim në portale ose televizione, sepse ai nuk e ka dhënë jetën e tij për interesin personal, por për lirinë e vendit tonë, andaj ju ftoi edhe një herë që të jeni të kujdesshëm në këtë drejtim në të ardhmen.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë vetë kam dalur në teren për 'Ditën e Çlirimit', nuk ju kam ftuar si Kuvend i Komunës, sepse i dini vetë vështirësitë që i kemi patur në vitet e kaluara, por unë në emër të Kuvendit të Komunës, kam vendosur buxheta me lule tek busti i Komandantit Legjendarë 'Adem Jashari' dhe tek varrezat e dëshmorëve. Vendosja e luleve te dëshmorët dhe martirët e lirisë, ka qenë organizim i Administratës, jo i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Vazhdimi i mbledhjes së datës 30.05.2024, me datën 18.06.2024 përfundoi në ora 11:00h.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili

